



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
 Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve



Nr. _____ Prot.

Tirane 04.12.2013

Relacion

Shtyrjen e afatit te vendimit Nr. 54.date 03.05.2013 te Bordit te Komisionereve te ERE-s
“Mbi shtyrjen e afatit te Vendimit nr. 161, date 07.12.2012, te Bordit te Komisionereve

Bordit te Komisionereve

Enti Rregullator i Energjise, ne zbatim te neneve 8, 9 dhe 26 te Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike“, te ndryshuar, dhe neneve 18, 20 dhe 21 te Rregullave te Praktikave dhe Procedurave te ERE, miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve nr. 21 date 18.03.2009, i ndryshuar, me Vendimin nr. 54 date 03.05.2013, vendosi:

Shtyrjen deri ne 31 Dhjetor 2013 te afatit te vendimit nr. 161, date 07.12.2012 i cili linte ne fuqi tarifat e miratuara nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 144, date 07.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a, për Periudhën e Tretë Rregullatore”, vendimin nr. 87, date 29.06.2012, “Për rishikimin e tarifës për Furnizuesin Publik me Shumicë për Periudhën e Tretë Rregullatore për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80 datë 15.06.2012 të Bordit të Komisionereve të ERE-s”, vendimin nr. 151, date 7.12.2011 “Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga TEC Vlora sh.a tek FPSH, për Periudhën e Tretë Rregullatore, vendimin nr. 146, date 7.12.2012 te Bordit te Komisionerëve “Për miratimin e tarifës se transmetimit te energjisë elektrike nga OST sh.a. për Periudhën e Tretë Rregullatore”, vendimeve nr.147, date 07.12.2011 “Per përcaktimin e tarifës se shperndarjes te energjise elektrike per periudhen e trete rregullatore 2012-2014, vendimin nr.148 date 07.12.2011 “Per përcaktimin e cmimeve te shitjes me pakice te energjise elektrike per konsumatorët tarifore per periudhen e trete rregullatore”, vendimi nr.149 date 07.12.2012 “Per përcaktimin e cmimit unik te shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW per vitin 2012”, vendimi nr. 150 date 07.12.2012 “Per përcaktimin e cmimit unik

te shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet egzistues me fuqi te instaluar deri ne 10 MW per vitin 2012.

Problematikat kryesore qe cuan ne marrjen e ketij vendimi ishin:

- Zbatimi i kushteve te vendosura ne Deklaraten Rregullatore ne lidhje me parashikimin e gjenerimit publik sipas ketij akti si edhe vleresimin aktual te kushteve te favorshme hidrologjike per cdo vit te periudhes 2012-2014 perfshi destinacionin perkates te perdorimit (tregimit) te sasise energjise elektrike pertej sasise te parashikuar ne Deklaraten Rregullatore.
- Paqartesi ne menyren e perlloratijes se treguesve, per efekt te llogaritjes se tarifave per aktivitetet e rregulluara, perfshire shitjen e energjise elektrike per vitin 2012 dhe parashikimin e shitjeve te energjise elektrike per konsumatorët tarifore per periudhen 2013-2014, nivelet e humbjeve te pranuar ne tarife si kosto te arsyeshme, si dhe investimet e lidhura me to, pamundesia per arritjen ne momentin e marrjes se vendimit te mesiperm te nje rakordimi per shkak te mosmarreshjeve midis KESH sh dhe CEZ sh.a. per energjine e dhene me teper per mbulimin e humbjeve gjate viteve 2011 dhe 2012.
- Ndryshimi i statusit te HEC Bistrica 1 dhe 2 dhe HEC Ulez Shkopet, per shkak te shitjes se aksioneve te ketyre kompanive tek investori privat, dhe te drejtes se ketij te fundit (investitorit) per te vendosur nese do te operoje me tej me KESH sh.a apo ne treg te parregulluar) gje qe conte ne pasiguri te burimeve dhe sasise se energjise elektrike dhe çmimit perkates qe FPSH-ja duhet te siguronte per përmbushjen e kontrates me FPP-ne.
- Statusi ne administrim te perkohshem te shoqerise CEZ Shperndarje; Ne kushtet e statusit juridik te kompanise CEZ Shperndarje si nje shoqeri te ciles i ishin hequr licencat dhe ishte vendosur nen administrim te perkohshem deri ne momentin e shpronësimit, krijonte paqartesi ne menyren e llogaritjes se komponenteve qe lidhen me percaktimin e te ardhurave te kerkuara per kryerjen e aktiveteve te rregulluara te kesaj shoqerie. Kjo lidhej kryesisht me treguesit e performances se shoqerise, per te cilat ne kontraten e shitjes se aksioneve jane vendosur objektiva te qarta dhe te pranuar nga investitori strategjik CEZ a.s.

Keto problem vazhdojne te ekzistojne ende, deke qene se:

- Kompania CEZ Shperndarje referuar vendimin nr.5 janar 2013 eshte ne admninstrim te perkohshem
- CEZ Shperndarje dhe KESH sh.a nuk ka mbyullur rakordimet per blerjet dhe shitjet e energjise elektrike midis tyre per periudhen 2011 -2012 si pamundesi kjo per shkak te statusit juridik te CEZ Shperndarje sh.a gjate ketij viti (keto jane fatura te papranuara nga

administrimi i meparshem i kompanise CEZ Shperndarje te cilat priten te zgjidhen gjate zgjidhjes se mosmareveshjes dhe konfliktit me CEZ a.s.)

- Vendimi nr. 87 date 29.06.2012 i Bordit te Komisionereve te ERE ka percaktuar tarifen e furnizuesit publik me shumice per periudhen 2012-2014 ne vleren 2.2 leke.
- Percaktimi i te ardhurave te teperta per efekt te axhustimit te tarifes se transmetimit te cilat rezultojne nga rritja e sasise se levruar te energjise elektrike per mbulimin e humbjeve ne sistetimin e shperndarjes eshte i kushtezuar me tarifen e shperndarjes.
- Percaktimi i tarifes se shperndarjes eshte i lidhur me vleresimin me pare te komponenteve te saj te tille si niveli i humbjeve, sasia e levruar ne rrjetin e shperndarjes, investimet e kryera te cilat jane te lidhur me treguesit e performances se kompanise se shperndarjes te cilat jane te fiksuara ne Deklaraten Regullatore.

Lidhur me sa me siper pikërisht statusi juridik i kompanise ne administrim te perkoshem per shkak te heqjes se licencave te aktivitetit te shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakice, ben te pamundur vlerësimin e tarifave per keto aktivitete sepse treguesit e performaces te vendosur ne Deklaraten Rregullatore (DR) i adresohen te licensuarit dhe investitorit perkates. Sikuresse jeni ne dijeni keto tregues te Deklartes Rregullatore jo vetem qe nuk u arriten por edhe jane perkeqesuar duke sjell nje efekt te ndjeshem ne te ardhurat e kompanise per te cilet ERE nuk mund te marre vendim per sa kohe qe mbetet i perkohshem statusi juridik i CEZ Shperndarje sh.a. dhe DR vazhdon te jete ne fuqi.

Ne perfundim duke konstatuar paqartesi te situates ne sektorin Energjise elektrike ne drjetim te statusit juridik dhe elemteve te tjere konkretisht:

- Operimi ne treg i aktiviteteve te shperndarjes dhe furnizimit publik me pakice nga shoqeria Cez Shperndarje ne statusin e administrimit te perkohshem per shkak te heqjes se licensave perkatese, si dhe te zbatimit te akteve ligjore qe jane te lidhura drejtpersedrejt me aktet ligjore te privatizimit. (Dokumentat e tenderit te perzgjedhjes se investitorit strategjik, kontrata e shitjes se 76 % aksioneve).
- Paqartesia e menyres se perlloratijes se treguesve te Furnizuesit publik me shumice, Operatorit te Sistemit te Transmetimit per efekt te te ardhurave te teperta te krijuara pergjate vitit 2013 si pasoje e prodhimit pertej parshikimeve te tarifes, si dhe transmetimit

te energjise elektrike se levruar ne rrejtin e shperndarjes, nivelet e humbjeve te pranuar ne tarife si kosto te arsyeshme, si dhe investimet e lidhura me to, pamundesia per arritjen deri me tani te nje rakordimi per energji e dhene me teper per mbulimin e humbjeve gjate viteve 2011 dhe 2012, per shkak te mosmarreshjeve midis paleve.

- Nga ana e Kuvendit te Shqiperise eshte miratuar ne date 2.5.2013 Ligji 138/2013 “Per burimet e energjise se rinovueshme”. Ky ligj eshte botuar ne fletoren zyrtare nr. 83, date 20.05.2013 dhe hyn ne fuqi 15 dite pas kesaj date. Nder te tjera ky ligj ne nenin 15 pika 1 percakton se *Këshilli i Ministrave, me propozim të ERE-s, miraton metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë elektrike, që do t'i paguhet prodhuesit me përparësi, për të gjitha llojet e centraleve, që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie.* Aktualisht ERE eshte ende ne fazen e përpunimit te te dhenave me prodhuesit e vegjel dhe gjithashtu eshte objekt i diskutimit edhe përcaktimi i subjekteve qe do te përfshihen ne efektet e zbatimit te ketij ligji dhe metodologjise perkatese. Ne lidhje me kete detyrim sqarojme se grupi i punes i ngritur per kete qellim ka kërkuar te dhena nga te gjitha subjektet qe operojne ne aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike nga centralet me fuqi te instaluar deri ne 15 MW. Disponimi i ketyre te dhenave do te mundësonte llogaritjet paraprake per te finalizuar Metodologjine e sipercituar per sa kërkuar ne ligj. Ende te dhenat nuk jane derguar plotesisht nga te gjitha subjektet dhe shpesh here te dhenat jane te ndryshme ne dokumentat e paraqitura ne ERE. Nese do ti referoheshim rregullimit ekzistues sipas metodologjie te miratuar nga ERE sipas Vendimit te Këshillit te Ministrave Nr. 87, date 16.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr. 27 date 19.01.2007”, Vendimit nr. 24, datë 11.04.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, nga llogaritjet tarifa nga 9.3 leke/kwh do te rezultonte 8.41 leke/kwh.
- Miratimi i cmimit mesatar trevjecar eshte bazuar ne mesatarizimin e te ardhurave te kerkuara per te tre vite, duke krijuar keshtu mundesi per nje operim ne kushte normale per gjate peridhes rregullatore 2013-2014.

- Duke qene nje tarife trevjecare cdo kosto e paprashikuar dhe e ardhur e tepert per operatoret e rregulluar do te axhustohet ne vitin pasardhes brenda periudhes se trete rregullatore.

Nga ana tjeter gjate vitit 2013 Miratimi i skedulit te pagesave dhe ndjekja e tij ne vazhdimesi ka stabilizuar gjendjen e likuiditeteve te operatoreve ne treg perfshire KESH sh.a, OST, Prodhuesit e Vegjel apo PPE, dhe ka bere te mundur krijimin e burimeve te brendeshme per shoqerine e shperndarjes ne kryerjen e nje aktiviteti normal.

Per gjithë sa me sipër i propozojmë Bordit të Komisionereve lenien ne fuqi deri ne date 31 dhjetor 2014, te tarifave te miratuara perkatesisht me vendimet si me poshte :

- Vendimin nr. 144, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga KESH sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 87, date 29.06.2012 “Per rishikimin e tarifes per Furnizuesin Publik me Shumice per Periudhen e Trete Rregullatore per akomodimin e efekteve financiare te vendimit Nr.80 date 15.06.2012 te Bordit te Komisionereve te ERE-s”.
- Vendimin nr. 151, date 7.12.2011 Per percaktimin e cmimit te shitjes te energjise elektrike te prodhuar nga TEC Vlore sh.a. tek FPSH, per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 153, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga HEC Lanabregas sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 146, date 7.12.2011 te Bordit te Komisionereve “Per miratimin e tarifes se transmetimit te energjise elektrike nga OST sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin Nr.147, date 07.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se shperndarjes te energjise elektrike per periudhen e trete rregullatore 2012-2014 dhe Nr.148 date 07.12.2011 “Per percaktimin e cmimeve te shitjes me pakice te energjise elektrike per konsumatoret tarifore per periudhen e trete rregullatore”.

- Vendimi Nr.149 date 07.12.2011 “Per percaktimin e cmimit unik te shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW per vitin 2012” .
- Vendimi Nr. 150 date 07.12.2011 “Per percaktimin e cmimit unik te shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet egzistues me fuqi te instaluar deri ne 10 MW per vitin 2012”.

2- Perditesimin dhe kompesimin e te gjitha efekteve financiare brenda te njejtës periudhe rregullatore 2012-2014, apo ne periudhen rregullatore pasardhese, periudhe e cila do te sherbeje per qartesimin e gjendjes juridike te kompanise se shperndarjes, duke i krijuar keshtu mundesine rregullatorit per qartesimin, verifikimin dhe percaktimin sa me te drejte te treguesve te te ardhurave te kerkuara per aktivitetit e gjenerimit publik, furnizimit me shumice, transmetimit, shperndarjes se energjise elektrike dhe furnizimit me pakice te konsumatorët tarifore.

Konceptoi:

Doris Carcani	Elida Mata	Merita Islami	Eltona Dragoti
Lavdie Konjari	Enton Shahaj	Erind Kraja	

Miratoi:

Eduard Elezi	Raimonda Islamaj	Erjola Sadushi	Agim Nashi
--------------	------------------	----------------	------------

